

Terminat dhe Kushtet e pergjithshme (AGB) Përfitimet e në bazë të Sigurimit të kompanisë Pikellimi GmbH

§ 1 Qëllimi i mbështetjes të shpënzimeve funerale

1. Ndiheja dhe mbështetja të shpënzimeve për varrim është një institucion i kompanisë Pikellimi GmbH, organizuar me qëllim që të ju ndihmojë anëtarëve dhe familjeve të tyre dhe të marrë përsipër shpenzimet për bartjen e kufomave.

§ 2 Kushtet paraprake për anëtarësim

1. Anëtar mund të bëhen ata që kanë mbushur moshën 18 vjeç.
2. Të interesusit duhet të ketë rezidencën e përhershme në territorin e Gjermanisë, vendet e Bashkimit Evropian (BE) ose në Zvicër dhe Zonën Ekonomike Evropiane (ZEE).

§ 3 Pranimi

1. Pranimi në institucionin bëhet sipas kërkesës për aplikim me formularin e Pikellimit GmbH.
2. Aplikimi i bashkëngjitur dokumentat e nevojshme dhe të domosdoshme dhe të njejtat duhet të dërgohen në adresën e kompanisë Pikellimi GmbH, Leipziger Str. 16a, 63584 Gründau. Pranohen vetëm aplikimet që janë plotësisht dhe të plotësuar me dhënat të personale dhe të pajisur me të gjithë dokumentacionin e nevojshëm.
3. Nuk ka asnjë pretendim ligjor për pranimin e të interesusit. Kompania Pikellimi GmbH mund të refuzojë interesuesin pa arsytim.

§ 4 Fillimi i mbrojtjes

Mbrojtja fillon vetëm kur:

1. Vërtetimi i mbrojtjes është dërguar me postë dhe kushtet e mëposhtme janë plotësuar:
2. Taksa e pranimit sipas §5 dhe kontributet e vitit sipas §6 janë të realizuara dhe ka skaduar periudha e kohës sipas § 4 Nr.3.
3. Skadimi i kohës 180 ditë pas realizimit dhe konfirmimit së pagesës;
4. Në rast se anëtarit pas realizimit të pagesës në një aksident ndron jetë, përjashtohet koha e skadimit sipas §4 Nr. 3.

§ 5 Taksa

1. Me pranimin e mbrojtjes duhet të realizohet taksa (Tarifë pranimit vetëm një here) drejt Pikellimit GmbH që janë stivësuar sipas moshës në vijim.

Mosha: 18 - 29 / Çmimi: 0,00 € | **Mosha: 30 - 49 / Çmimi: 49,95 €** | **Mosha: 50 - 54 / Çmimi: 399,95 €** | **Mosha: 55 - 59 / Çmimi: 599,95 €**

2. Taksa e pranimit duhet të realizohet dy javë pas marrjes së faturës dhe vërtetimit mbrojtjes.

§ 6 Kontributet vjetor dhe kushtet e pagesës

1. Kontributet vjetore janë **89,95 Euro** dhe paraprakisht nga çdo antar duhet të realizohen në kohë. Kontributi vjetor pas pranimit duhet të realizohet dy javë pas marrjes së faturës dhe vërtetimit se mbrojtjes. Pas kësaj çdo vit, 3 ditë punë pas regjistrimit në muajin e vitin e kaluar.
2. Kontributet vjetore realizohen kryesisht direkt nga llogaria e anëtarësuesit pas autorizimi nga banka. Nëse banka refuzon kërkesën e Pikellimit GmbH anëtarësuesi do të marrë përsipër kostot e shkaktuara.
3. Mbështetja e „Sigurimit“ përjashtohet nëse anëtarit vonohet me pagesën më shumë se 1 muaj.

§ 7 Përfitueset nga mbrojtja

1. Personat që mbështen nga „Sigurimi“ janë:
 - a. anëtarit dhe bashkëshortit-ja;
 - b. fëmijët e anëtarit të cilët nuk e kanë arritur ende moshën 18 vjeçare;
 - c. fëmijët e anëtarit që janë studente me kusht që ato të mos e kenë arritur akoma moshën 27 vjeçare ose që janë të pamartuar dhe nuk kanë të ardhura të mjaftueshme;
 - d. fëmijët me aftësi të kufizuara të rëndë (50%) dhe të cilët nuk kanë të ardhura të mjaftueshme (pa moshën e kufizuar);
 - e. personat e lartpërmendur humbin pa njoftim mbështetjen e „Sigurimit“ në qoftë se nuk plotësojnë kushtet të Nr. 1 a) deri d) kanë mundësi (p.sh. pas divorcit ose mbushjen 18 vjeçare etj) të aplikojnë për anëtarësim dhe mbrojtje me drejta të plota. Në situata të tilla përjashtohet taksa e regjistrimit ku vetëm realizohet pagesa e kontributeve vjetore për vitin që i përket.

§ 8 Mbështetja e anëtarit

1. Sapo anëtarit ose të familja e tij, sipas kuptimit të §7, e njofton Pikellimin GmbH në një rast vdekjeje, „Sigurimi“ porositi një institucion për bartjen e kufomave dhe perfshirjen e shërbimive të mëposhtme:
 - a. kompletimi dhe realizimi i të gjitha çështjeve administrative;
 - b. përgatitja e trupit sipas rregullave të zgjedhur në aplikim;
 - c. transport i sigurtë deri në vendin e varrimit;
 - d. Trupi varroset në përputhje me standardet evropiane;
2. Familjes së të ndjerit nuk ju lejohet të angazhojnë ndonjë institucion tjetër pa u konsultuar me Pikellimi GmbH. Në raste të tilla Pikellimi GmbH nuk do të marrë shpenzimet përsipër.
3. Për ata që varroset në territorin e Bashkimit Evropian, EEA ose në Zvicër, shpenzimet merren përsipër plotësisht deri 3.000 Euro.
4. Nëse një anëtar i Pikellimit GmbH ndron jetë në vendlindjen e tij, anëtarët e familjes e tij marrin një shumë prej 500 Euro si ndihmë financiale.
5. Ata që ndrojnë jetë jashtë BE, EEA apo Zvicër mundet sipas dëshires të familjes të transferohen nga Pikellimi GmbH në vendet e BE, EEAs ose në Zvicër. Sipermarja e shpënzimeve në këto rastë është deri 3.000 Euro.
6. Në rast të një aborti (më pak se 500g) sipas ligjeve të vendit mbulohen shpenzimet e varrimit deri në 700 Euro.
7. Dokumentet që duhet të ju ofrohen institucionit për bartjen e kufomave: Kartela e identifikimit (ID), pasaporta, certifikata e vdekjes ose raporti i vdekjes, certifikata e martesës (ndërkohësisht, përndryshe me përkthim në gjuhën gjermane) dhe vërtetimi të mbrojtjes “Certifikata e sigurimit”. Në rast se dokumentacioni i nevojshëm nuk i dërgohet në kohë Pikellimi GmbH, “Sigurimi” nuk e mer përsipër shpenzimet të tjera që i paraqet.
8. Në dështim të trafikut rrugor ose venesë të tjera që arsyetohen që nuk i takon “Sigurimit” (p.sh. për shkak të festave, vonesë apo dështimin e fluturimeve dhe institucionit për bartjen e kufomave), kompania Pikellimi GmbH nuk do përgjegjë ndaj anëtarit ose familjes së tij.

§ 9 Detyrim informacioni të anëtarit

1. Çdo anëtar është i detyruar të raportojë informacione në lidhje me anëtarët e familjes së tij të Pikellimi GmbH, tërësisht dhe me vërtetësi. Pikellimi GmbH nuk përgjigjet në rast mungesë të informacioneve dhe dokumenteve.

§ 10 Ndërprerja e kontratës

1. Afati i kontratës është 5 vjet dhe zgjatet plus, një vit në qoftë se kontrata nuk është ndërprerë, në përputhje me kushtet e mëposhtme.
2. Kontrata e mbrojtjes ndërprehet nga dorëheqja, përjashtimi ose vdekja e antarit.
3. Çdo anëtar mund të ndërpresë kontratën në fund të vitit. Njoftimi duhet të jetë me shkrim dhe jo më vonë se 3 muaj para përfundimit të kontratës vjetore.
4. Mbrojtja përfundon nëse kërkesat shqyrtohen në § 2 paragraf. 1-2 dhe aplikacioni nuk dorëzohet në kohë ose janë me vonesë.
5. Anëtarit mund të përjashtohet nga kompania Pikellimi GmbH, veçanërisht kur:
 - a) i shkel ligjet të kompanies Pikellimi GmbH apo ndonjë të vendeve të tjera.
 - b) vonon kontributet vjetore 3 muaj mbas ftesës për pagesë.
6. Me ndërprerjen e kontratës humben të gjitha të drejtat dhe detyrimet e anëtarit për mbrojtje. Me këtë rast humbet rikthimi i mjeteve të paguara.

§ 11 Dispozita të tjera

1. Vetëm formulari i aplikimit dhe termat dhe kushtet e përgjithshme (AGB) janë të vlefshme për kontratën. Marrëveshje verbale ose deklarata të tjera janë të pavlefshme.
2. Nëse një ose më shumë dispozita të kësaj kontrate të “Sigurimit” janë ose bëhen të pavlefshme, vlefshmëria e dispozitave të tjera të kontratës mbesin të paprekshme.

§ 12 Transferimi të dhënave, Ligj i fuqishëm dhe vendi juridik

1. Klienti e autorizon Pikellimin GmbH që të përdorë të dhënat e tij personale për përdërim në bazë të ligjit. Transferimi i dhënave për arsye komerciale ose për arsye të tjera, nuk i lejohet Pikellimit GmbH.
2. Marrëdhënia juridike ndërmjet personit të siguruar dhe të kompanisë Pikellimi GmbH zbatohen kryesisht me ligjet e Gjermanisë.
3. Selia gjyqësore është në rajonin e Pikellimi GmbH.